



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK. Nr. 251/2020

Datë: 18 nëntor 2020

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.12, neni 16 paragrafi 1, pika 1.4 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 17 dhe 22 i Rregullores Nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 242-të, të mbajtur me datë 18 nëntor 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Z. Vilard Bytyqi, anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, caktohet anëtar rezervë i Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel.
- II. Mandati i z. Bytyqi, është tri (3) vite.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 18 nëntor 2020.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 18 nëntor 2020, ka shqyrtuar çështjen për caktimin e anëtarit në Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel, pas përfundimit të mandatit si anëtare e Këshillit të Gjyqësor të Kosovës të znj. Makifete Saliuka, e cila ka qenë anëtare rezervë e këtij komisioni.

KGJK, ka vendosur që si anëtar i Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel të caktohet z. Vilard Bytyqi, anëtar i KGJK-së, me mandat tre (3) vjeçar, ndërsa anëtarët e tjerë të këtij komisioni mbeten si në vendimin KGJK.nr.30/2020.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Skender ÇOÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Vilard Bytyqi, anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Anëtarëve të Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe
- Arkivit.